

VENDIM
Nr. 442, datë 26.6.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË NDALIMIT TË EKSPORTIT TË MERKURIT METALIK, KOMPONIMEVE DHE PËRZIERJEVE TË CAKTUARA TË MERKURIT, RUAJTJES SË SIGURT TË MERKURIT METALIK DHE TË KRITEREVE SPECIFIKE TË RUAJTJES SË MERKURIT METALIK TË KONSIDERUAR SI MBETJE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për ndalimin e eksportit të merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, ruajtjen e sigurt të merkurit metalik dhe të kritereve specifike të ruajtjes së merkurit metalik të konsideruar si mbetje, sipas tekstit dhe shtojcave I, II, III, IV e V, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, ministria përgjegjëse për industrinë, inspektorati shtetëror përgjegjës për mjedisin, inspektorati shtetëror përgjegjës për tregtinë, inspektorati shtetëror përgjegjës për industrinë dhe minierat, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe operatorët ekonomikë, të përmendur në këtë vendim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet juridike pas datës 1 janar 2020.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULLAT

PËR NDALIMIN E EKSPORTIT TË MERKURIT METALIK, KOMPONIMEVE DHE PËRZIERJEVE TË CAKTUARA TË MERKURIT, RUAJTJEN E SIGURT TË MERKURIT METALIK DHE KRITERET SPECIFIKE TË RUAJTJES SË MERKURIT METALIK TË KONSIDERUAR SI MBETJE

I. OBJEKTI, PËRKUFIZIMET DHE FUSHA E ZBATIMIT

1. Objekti

Objekti i këtij vendimi janë përcaktimi i rregullave, masave dhe kushteve në lidhje me përdorimin, ruajtjen, tregtimin e merkurit, komponimeve që përmbajnë merkur dhe përzierjeve të merkurit, prodhimin, përdorimin dhe tregtimin e produkteve me merkur të shtuar, si dhe menaxhimin e mbetjeve të merkurit.

Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga shkarkimet antropogjene dhe çlirimet e merkurit dhe komponimeve që përmbajnë merkur.

2. Përkufizime

¹ Ky vendim përfron pjesërisht Rregulloren (EU) 2017/852 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 maj 2017 mbi merkurin, që shfuqizon Rregulloren (EC) nr. 1102/2008 (Text with EEA relevance) *OJ L 137, 24.5.2017, f. 1–21. CELEX: 32017R0852.*

Për qëllime të këtij vendimi, të gjithë termat kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Asgjësim”, sipas kuptimit të përcaktuar në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;

b) “Dokument dorëzimi”, sipas kuptimit të përcaktuar në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;

c) “Eksport”, dalja e merkurit, komponimeve të merkurit, përzierjeve të merkurit dhe produkteve me merkur të shtuar;

ç) “Rieksportim”, dalja e merkurit, komponimeve të merkurit, përzierjeve të merkurit dhe produkteve me merkur të shtuar, të cilat i nënshtrohen një procedure doganore të posaçme, të ndryshme nga procedura e transitit të jashtëm, nëpërmjet territorit doganor të Shqipërisë ;

d) “Import”, hyrja fizike në territorin doganor të Shqipërisë të merkurit, komponimeve të merkurit, përzierjeve të merkurit dhe produkteve me merkur të shtuar, të cilat i nënshtrohen një procedure doganore të ndryshme nga procedura e transitit të jashtëm për lëvizjen e mallrave nëpërmjet territorit doganor të Shqipërisë;

dh) “Komponim mercuri”, çdo substancë që përbëhet nga atomet e merkurit dhe një ose më shumë atome të elementeve të tjera kimike, që mund të ndahen në komponentë të ndryshëm vetëm nëpërmjet reaksioneve kimike;

e) “Konventë”, Konventa e Minamatës, për merkurin;

ë) “Mbetje mercuri”, mercuri metalik që klasifikohet mbetje, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;

f) “Merkur”, mercuri metalik (Hg, Nr. CAS 7439-97-6);

g) “Nxjerrje parësore e mineralit të merkurit”, nxjerrja e mineraleve, ku përbërësi kryesor që kërkohet është mercuri;

gj) “Operator”, sipas përcaktimit në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;

h) “Palë në konventë” ose “Palë”, një shtet ose një organizatë rajonale e integritit ekonomik, që ka rënë dakord për t’u detyruar nga kjo konventë dhe për të cilat konventa është në fuqi;

i) “Produkt me merkur të shtuar”, një produkt ose komponime të produktit që përmban merkur ose një komponim mercuri të shtuar në mënyrë të qëllimshme;

j) “Produkte të reja me merkur të shtuar”, produktet me merkur të shtuar, të prodhuara pas hyrjes në fuqi të këtyre rregullave;

k) “Ruajtje e përkohëshme”, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;

l) “Shndërrim”, transformimi kimik i gjendjes fizike të merkurit, nga një gjendje e lëngshme deri në sulfur mercuri ose një përbërje kimike të krahasueshme, që është njëloj ose më e qëndrueshme dhe e barabartë ose më pak e tretshme në ujë dhe që nuk paraqet rrezik më të madh për mjedisin ose shëndetin e njeriut sesa sulfuri i merkurit;

ll) “Shtet tjetër” ose “jo Palë”, çdo shtet që nuk është palë në Konventë;

m) “Teknika më e mirë në dispozicion”, teknika që është më efektive për të parandaluar dhe, kur kjo nuk është praktike, që zvogëlon emetimet dhe shkarkimet e merkurit në ajër, ujë dhe tokë dhe ndikimin e emetimeve të tilla e të shkarkimeve në mjedis si një e tërë, duke marrë parasysh rrethanat ekonomike dhe teknike për një vend ose objekt të caktuar brenda territorit.

3. Fusha e zbatimit

Këto rregulla zbatohen për të gjithë personat fizikë ose juridikë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët:

a) eksportojnë, importojnë, përdorin, ruajnë dhe tregtojnë merkur, komponime që përmbajnë merkur dhe përzierje mercuri;

b) prodhojnë dhe përdorin produkte me merkur të shtuar;

c) menaxhojnë mbetjet e merkurit.

II. EKSPORTI, TREGTIMI DHE KUFIZIMET MBI PRODHIMIN E MERKURIT, KOMPONIMEVE TË MERKURIT, PËRZIERJEVE TË MERKURIT DHE PRODUKTEVE ME MERKUR TË SHTUAR

II.1 Kufizimet e eksportit

1. Në Republikën e Shqipërisë ndalohet eksporti:

a) i merkurit;

b) i komponimeve dhe përzierjeve të merkurit, listuar në shtojcën I, të këtij vendimi, sipas afateve kohore të përcaktuara në këtë shtojcë;

c) për qëllime të rikuperimit të merkurit, të komponimeve dhe përzierjeve të tjera të merkurit, që nuk janë objekt ndalimi, sipas shkronjës “b”, më sipër.

2. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij kreu, lejohet eksporti i mbetjeve të merkurit vetëm për qëllime asgjësimi drejt shteteve, të cilat kanë në dispozicion kapacitetet teknike, infrastrukurore të nevojshme për kryerjen e shndërrimit, ngurtësimit të merkurit. Eksporti, në këtë rast, kryhet në përputhje me procedurat e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve dhe kërkesat e Konventës së Bazelit mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkuftare të mbetjeve të rrezikshme.

3. Kërkesat e shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu, nuk zbatohen në rastin e eksportit të komponimeve të merkurit të listuara në shtojcën I, të këtij vendimi, për qëllime kërkimore laboratorike ose analiza laboratorike. Personi që eksporton merkur, komponime dhe përzierje të merkurit, sipas përjashtimit të kësaj pike, duhet që, nëpërmjet një dokumenti të lëshuar nga subjekti që operon jashtë vendit, të vërtetojë se eksporti kryhet vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë pikë.

II.2. Kufizimet e importit

1. Në Republikën e Shqipërisë ndalohet importi:

a) i merkurit dhe i përzierjeve të merkurit të listuara në shtojcën I, të këtij vendimi;

b) i mbetjeve të merkurit;

c) i përzierjeve të merkurit që nuk përfshihen në shkronjat “a” dhe “b”, më sipër, dhe i komponimeve të merkurit për qëllime të rikuperimit të merkurit;

ç) i merkurit për përdorim në miniera dhe përpunim artizanal në shkallë të vogël të arit.

2. Përjashtimisht nga ndalimi në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij kreu, importi i merkurit dhe importi i përzierjeve të merkurit, të listuara në shtojcën I, të këtij vendimi, për një përdorim të caktuar, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e kimikateve, do të lejohet kur ministria përgjegjëse për mjedisin/Zyra e kimikateve, në zbatim të detyrimeve sipas Konventës së Merkurit, ka dhënë pëlqimin me shkrim për atë import.

Pëlqimi me shkrim jepet kur:

a) shteti eksportues është Palë në Konventë dhe merkuri që do të eksportohet nuk konsiderohet si nxjerrje parësore e mineralit të merkurit, e ndaluar sipas Konventës;

b) shteti eksportues, që nuk është Palë në Konventë, siguron dokumentin se merkuri nuk konsiderohet si nxjerrje parësore e mineralit të merkurit.

3. Në çdo rast, vendosja në treg, depozitimi dhe ruajtja e merkurit kryhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e kimikateve, nga personat fizikë ose juridikë të pajisur me licencën përkatëse për prodhimin, vendosjen në treg, depozitimin dhe ruajtjen e kimikateve të rrezikshme.

4. Formatet për zbatimin e pikës 2, të këtij kreu, miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

II.3. Eksporti, importi dhe prodhimi i produkteve me merkur të shtuar

1. Ndalohet eksporti, importi dhe prodhimi i produkteve me merkur të shtuar sipas përcaktimeve dhe afateve kohore të parashikuara në shtojcën II, të këtij vendimi.

2. Përjashtimisht nga pika 1, e këtij kreu, ndalimi në pikën 1 nuk zbatohet për produktet, të cilat:

a) janë thelbësore për mbrojtjen civile dhe përdorimet ushtarake, sipas përcaktimit të legjislacionit përkatës në fuqi në fushën e mbrojtjes civile dhe të mallrave ushtarake;

b) përdoren për qëllime kërkimore, kalibrimin e instrumenteve ose si standarde referimi. Personi fizik ose juridik, i cili eksporton/importon produkte me merkur të shtuar, duhet të provojë, nëpërmjet një dokumentacioni, se eksporti/importi kryhet vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë pikë.

III. RUAJTJA E SIGURT E MERKURIT, KOMPONIMEVE DHE PËRZIERJEVE TË MERKURIT, SI DHE KUFIZIMET MBI PËRDORIMIN E MERKURIT NË PROCESET E PRODHIMIT, PËRDORIMI AMALGAMËS DENTARE

III.1. Ruajtja e merkurit, komponimeve dhe përzierjeve të merkurit dhe përdorimet e tyre në proceset e prodhimit

1. Përdorimi i merkurit dhe i komponimeve të merkurit në proceset e prodhimit lejohet vetëm në përputhje me kufizimet, kushtet dhe afatet kohore të përcaktuara në pjesën II, të shtojcës III, bashkëlidhur.

2. Ndalohet përdorimi i merkurit dhe i komponimeve të merkurit në proceset e prodhimit, sipas përcaktimeve dhe afateve kohore të parashikuara në pjesën I, të shtojcës III, të këtij vendimi.

3. Për aktivitetet industriale, të reja ose ekzistuese, që synojnë të përdorin procese që çlirojnë merkur dhe komponime mercuri, AKM-ja, gjatë procesit të pajisjes me lejen përkatëse të mjedisit, përveç kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për lejet e mjedisit, vlerëson edhe proceset dhe kushtet e përcaktuara në pjesën II, të shtojcës III, të këtij vendimi.

4. Për qëllime të këtij kreu, mercuri, komponimet dhe përzierjet e merkurit, që gjenden në shtojcën I, bashkëlidhur, ruhen në mënyrë të përkohshme kur ruajtja:

- a) siguron mbrojtjen e mjedisit;
- b) është në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet;
- c) përmbush kërkesat e pikës 3, të kreut II.2, të këtij vendimi;
- ç) është në përputhje me pragjet dhe kërkesat e përcaktuara në legjislacionin specifik për kontrollin e rreziqeve të aksidenteve madhore, që përfshijnë substanca të rrezikshme.

5. Kërkesat teknike për ruajtjen e përkohshme të merkurit, komponimeve të merkurit dhe përzierjeve të merkurit në mënyrë të sigurt për mjedisin përcaktohen me urdhër të ministrit.

III.2. Përpunimi artizanal dhe minierat e arit në shkallë të vogël

1. Në aktivitetet e nxjerrjes e arit nga minerali, në përpunimin artizanal, si dhe në minierat e arit në shkallë të vogël ndalohet përdorimi i amalgamave të merkurit.

2. Kur konstatohen raste të mospërmbushjes së ndalimit të pikës 1 dhe të kërkesave të kreut VI, më poshtë, ministria përgjegjëse për industrinë përgatit planin kombëtar të veprimit, me masat që duhen ndërmarrë dhe në përputhje me kërkesat e shtojcës IV, bashkëlidhur.

III.3. Amalgamat dentare

1. Amalgama dentare, e përftuar nga përzierja e merkurit elementar të lëngët dhe një aliazhi në formë pluhuri, të përbërë nga argjendi, kallaji dhe/ose bakri, përdoret si material mbushës dentar për trajtimin dentar të dhëmbëve, në përputhje me kërkesat e këtij kreu.

2. Nga data 1 korrik 2021 lejohet përdorimi i amalgamave dentare vetëm në formën e dozave të preparateve të kapsuluara. Në klinikat dentare ndalohet përdorimi i merkurit në gjendje të lirë.

3. Nga data 1 korrik 2021, ndalohet përdorimi i amalgamave dentare për trajtimin dentar të dhëmbëve të qumështit, të fëmijëve nën moshën 15 vjeç dhe të femrave shtatzëna ose që janë në proces ushqyerje me gjë.

4. Përjashtim nga zbatimi i pikës 3, të këtij kreu, bën përdorimi i amalgamave dentare në rastet kur dentisti e konsideron përdorimin e amalgamave dentare të nevojshme për shërbimin dentar ndaj pacientit.

5. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, brenda datës 1 korrik 2021, përgatit planin kombëtar me masat që do të ndërmerren për heqjen nga përdorimi të amalgamës dentare në vend, i cili, brenda 1 muaji, nga data e miratimit, publikohet në faqen zyrtare të ministrisë.

6. Ndarësi i amalgamës (separator) për mbajtjen dhe grumbullimin e pjesëzave/grimcave të amalgamës, përfshirë edhe pjesëzat që gjenden në ujin e përdorur gjatë këtyre procedurave, pas datës 1 janar 2021 është detyrim vetëm për ata ofrues të shërbimit dentar, të cilët përdorin amalgamën dentare apo kryejnë heqjen e mbushjeve me amalgamë dentare në klinikat e tyre.

7. Sipas përcaktimit në pikën 6, të këtij kreu, merren masat, si më poshtë vijon:

a) Ndarësit e amalgamës, që janë në përdorim pas datës 1 janar 2020, të kenë një nivel mbajtjeje, të paktën, 95% të pjesëzave/grimcave të amalgamës;

b) Të gjithë ndarësit e amalgameve, që janë në përdorim pas datës 1 janar 2024, të sigurojnë nivelin e mbajtjes të përcaktuar në shkronjën “a”;

c) Ofruesit e shërbimit dentar të mirëmbajnë ndarësit e amalgameve në përputhje me udhëzimet e prodhuesit, për të siguruar nivelin më të lartë praktik të mbajtjes.

8. Kapsulat dhe ndarësit e amalgameve, që ofrojnë një nivel cilësie dhe mbajtjeje në përputhje me standardet evropiane, ose standarde të tjera kombëtare apo ndërkombëtare, duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në pikat 2 dhe 7, të këtij kreu.

9. Ofruesit e shërbimit dentar, që përdorin amalgama, marrin masat që mbetjet e amalgameve, pjesëzat dhe mbushjet e amalgameve, dhëmbët ose pjesët e tyre, të cilat përmbajnë ose janë të kontaminuara me amalgamë dentare, të grumbullohen dhe trajtohen nga subjekte të autorizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

10. Ofruesit e shërbimit dentar ndalohen të hedhin në mjedis, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbetjet e amalgameve.

11. Inspektorati përgjegjës për mjedisin dhe ai përgjegjës për shëndetësinë inspektojnë ofruesit e shërbimit dentar.

IV. KRITERET SPECIFIKE TË RUAJTJES SË MERKURIT, KOMPONIMEVE DHE PËRZIERJEVE TË MERKURIT TË KONSIDERUAR SI MBETJE, TRAJTIMI, ASGJËSIMI DHE GJURMUESHMËRIA E TYRE

IV.1 Ruajtja e mbetjeve të merkurit dhe trajtimi i tyre

1. Operatorët, që krijojnë dhe ruajnë mbetje, marrin masat për të shmangur kontaminimin e mbetjeve të tjera nga mbetjet e merkurit, komponimet e merkurit dhe përzierjet që përmbajnë merkur.

2. Mercuri dhe komponimet e merkurit, që gjenerohen në formë të pastër ose si përzierje nga burimet e mëdha, të përcaktuara në pikën 3, të këtij kreu, konsiderohen mbetje në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

3. Për qëllime të pikës 2, të këtij kreu, burime të mëdha konsiderohen:

a) industria klor-alkali;

b) pastrimi i gazit natyror;

c) operacionet minerare joferrore dhe ato të shkrirjes;

ç) nxjerrja nga mineralet e cinabarit.

4. Mbjetet e merkurit grumbullohen, transportohen dhe magazinohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe, sipas rastit, mund:

a) të ruhen përkohësisht në gjendje të lëngët, në përputhje me kërkesat e pikës 5, të këtij kreu;

b) t'i nënshtrohen proceseve të përcaktuara në pikën 6, të këtij kreu, për qëllime të ruajtjes së përhershme ose asgjësimit;

c) të ruhen në mënyrë të përhershme ose të asgjësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Procedurat e asgjësimit, në asnjë rast, nuk duhet të çojnë në rikuperimin e merkurit.

5. Mbjetet e merkurit, deri në datën 1 janar 2025, mund të ruhen përkohësisht në gjendje të lëngët, kur:

a) përmbushen kërkesat për ruajtjen e përkohshme, të përcaktuara në shtojcën V, të këtij vendimi;

b) ruajtja e përkohshme e mbetjeve të merkurit bëhet në objekte mbi tokë, të cilat plotësojnë kushtet e posaçme në pikën 6, të shtojcës V, të këtij vendimi.

6. Për qëllime të pikave 4 dhe 5, të këtij kreu, ruajtja e përkohshme e mbetjeve të merkurit kryhet nga persona fizikë ose juridikë të pajisur me lejen e mjedisit, sipas fushës III.1, të shtojcës së ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe licencën III.2.B, të fushës III, të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

7. Mbetjet e merkurit, para se t’i nënshtrohen procesit të ruajtjes së përhershme, kalojnë në procesin e shndërrimit. Në rastin kur asgjësimi parashikohet të ndodhë në objekte mbi tokë, mbetjet e merkurit i nënshtrohen shndërrimit dhe ngurtësimit.

8. Mbetjet e merkurit, që i janë nënshtuar procesit të shndërrimit dhe/ose ngurtësimit, do të ruhen në mënyrë të përhershme në:

a) Lendfill-et e mbetjeve të rrezikshme, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për lendfill-et;

b) minierat e kripës, të përshtatura dhe që përmbushin kërkesat e pikës 1, të shtojcës V, për ruajtjen e përhershme të mbetjeve të merkurit të shndërruara, ose në formacione të forta shkëmbore nën tokë, të cilat ofrojnë një nivel sigurie dhe izolimi të njëjtë ose më të lartë se minierat e kripës;

c) objektet mbi tokë, të përcaktuara dhe të pajisura për ruajtjen e përhershme të mbetjeve të merkurit të shndërruara dhe ngurtësuara, që sigurojnë një nivel sigurie dhe izolimi të njëjtë ose më të lartë se objektet në shkronjën “b”.

9. Operatori, që ruan mbetjet e rrezikshme, ka detyrimin që mbetjet e merkurit të shëndërruara dhe/ose ngurtësuara t’i ruajë sipas kushteve të mëposhtme:

a) në mënyrë të ndarë nga mbetjet e tjera;

b) të grupuara në një dhomë ruajtjeje të vulosur;

c) në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin për lendfill-et e mbetjeve;

ç) në përputhje me kërkesat specifike për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve të merkurit, sipas pikave 3 dhe 5, të shtojcës V, bashkëlidhur.

IV.2. Gjurmueshmëria

1. Gjurmueshmëria e mbetjeve të merkurit, që nga krijimi deri në destinacionin e tyre përfundimtar, kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

2. Personat fizikë ose juridikë, që ruajnë përkohësisht mbetjet e merkurit, krijojnë dhe mbajnë regjistrin me të dhënat, si më poshtë vijon:

a) me dërgesat e marra të mbetjeve të merkurit, i cili përfshin:

i. origjinën dhe sasinë e mbetjeve të marra;

ii. emrin dhe të dhënat e kontaktit të furnizuesit e të pronarit të mbetjeve.

b) me dërgesat e mbetjeve të merkurit që largohen nga objekti, i cili përfshin:

i. sasinë e mbetjeve dhe përmbajtjen e merkurit në to;

ii. destinacionin dhe operacionin e destinuar të asgjësimit të mbetjeve;

iii. kopje të dokumentit të lëshuar nga operatori që kryen shndërrimin dhe, nëse është e zbatueshme, ngurtësimin e mbetjeve, siç referohet në paragrafin 3, më poshtë;

c) me sasinë e mbetjeve të merkurit të depozituara në objekt, në fund të çdo muaji.

3. Kur mbetjet e merkurit dalin nga ruajtja e përkohshme, personi fizik ose juridik, sipas pikës 2, të këtij kreu, në përputhje edhe me legjislacionin në fuqi që rregullon eksportin e mbetjeve të rrezikshme, plotëson dokumentin e dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme. Subjekti duhet të deklarojë se këto mbetje janë dërguar, sipas rastit, në një impiant që kryen shndërrimin dhe/ose ngurtësimin e mbetjeve të merkurit ose në një impiant asgjësimi. Një kopje e dokumentit i përcillet pa vonesë operatorëve ekonomikë industrialë të interesuar, sipas kreut IV.2.

4. Personat fizikë ose juridikë, të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, dërgojnë në AKM çdo vit, deri në datën 31 janar, regjistrin e të dhënave për vitin e mëparshëm kalendarik.

IV.5. Zonat e ndotura

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përfshijnë në planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve edhe masat lidhur me zonat e ndotura me merkur dhe mbetje mercuri, që janë brenda territorit të tyre, rrezikun që ato paraqesin për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe masat për rehabilitimin e këtyre zonave.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, me institucione të tjera shtetërore, si dhe donatorët e ndryshëm (organizata), donatorët e huaj, për financimin e projekteve që reduktojnë riskun në zonat e ndotura me merkur dhe mbetje mercuri.

3. Ministrinë, inspektoratet përgjegjëse të tyre, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, INSTAT-i dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë me Ministrinë dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit informacionet e nevojshme lidhur me masat e marra për:

- a) adresimin e merkurit, komponimeve dhe përzierjeve të merkurit;
- b) identifikimin dhe vlerësimin e zonave të ndotura nga mercuri dhe komponimet e merkurit;
- c) adresimin e rreziqeve të kontaminimit të merkurit për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

4. Bazuar në të dhënat e grumbulluara në pikën 3, Ministria përgatit inventarin e zonave të ndotura nga mercuri dhe komponimet e merkurit në vend.

5. Brenda datës 1 janar 2023, Ministria publikon informacionin e mbledhur në përputhje me pikën 3, përfshirë edhe inventarin e zonave të ndotura nga mercuri dhe komponimet e merkurit.

V. RAPORTIMI

V.1. Raportimi i burimeve të mëdha

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon dhe mirëmban inventarin e shkarkimeve të merkurit në mjedis. Për qëllime të krijimit të inventarit, institucionet përgjegjëse dhe operatorët industrialë raportojnë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në përputhje me legjislacionin që rregullon krijimin e regjistrit kombëtar të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve.

2. Për qëllime të pikës 1, të këtij kreu, operatorët industrialë të burimeve të mëdha, sipas shkronjave ‘a’, ‘b’ e ‘c’, të pikës 3, të kreut IV.1, raportojnë çdo vit, brenda datës 31 maj, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, informacionin e mëposhtëm:

- a) sasinë totale të mbetjeve të merkurit, të ruajtura në instalimet e tyre;
- b) sasinë totale të mbetjeve të merkurit të dërguara në objekte/impianete, të cilat kryejnë:
 - i. ruajtjen e përkohshme, shndërrimin dhe, kur është e zbatueshme, ngurtësimin e mbetjeve të merkurit;
 - ii. ruajtjen e përhershme të mbetjeve të merkurit, që i janë nënshtruar procesit të shndërrimit dhe, nëse është e zbatueshme, ngurtësimin.
- c) vendndodhjen dhe të dhënat e kontaktit të çdo objekti/impianti të referuar në shkronjën ‘b’;
- ç) kopje të dokumentit të lëshuar nga personi fizik ose juridik, që kryen ruajtjen e përkohshme të mbetjeve të merkurit, në përputhje me pikën 2, të kreut IV.4;
- d) kopje të dokumentit të lëshuar nga personi fizik ose juridik, që kryen shndërrimin dhe, nëse është e zbatueshme, ngurtësimin e mbetjeve të merkurit, në përputhje me pikën 3, të kreut IV.4;
- dh) kopje të dokumentit të lëshuar nga operatori që kryen ruajtjen e përhershme të mbetjeve të merkurit që ka pësuar shndërrim dhe, nëse është e zbatueshme, ngurtësim, në përputhje me pikën 3, të kreut IV.4.

3. Operatorët industrialë të burimeve të mëdha, të dhënat sipas shkronjave ‘a’ dhe ‘b’, të pikës 2, i raportojnë në përputhje me kodet e përcaktuara në legjislacionin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve.

4. Kërkesat e pikave 1 dhe 2 nuk zbatohen për operatorët e instalimeve klor-alkaline, një vit pas nxjerrjes jashtë përdorimit të të gjithë sasisë së merkurit që operohet prej tij, në përputhje me teknikat më të mira në dispozicion për prodhimet klor-alkaline dhe kur e gjithë sasia e merkurit është dorëzuar në impiantet e menaxhimit të mbetjeve.

V.2. Raporti kombëtar

1. Ministria/Zyra e kimikateve, nga data 1 janar 2023, përgatit raportin kombëtar me të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) informacionin mbi zbatimin e këtij vendimi;
- b) informacionin e nevojshëm për përmbushjen nga Republika e Shqipërisë të raportimit, sipas kërkesave të Konventës;
- c) një përmbledhje të informacionit të siguar në përputhje me kreun IV.2;
- ç) informacion në lidhje me merkurin që ndodhet në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë një listë të vendeve:
 - i. ku gjenden rezervat e më shumë se 50 tonë metrikë merkur, përveç mbetjeve të merkurit dhe sasinë e merkurit në vend;
 - ii. ku grumbullohen më shumë se 50 tonë metrikë mbetje merkur, si dhe sasinë e mbetjeve të merkurit në vend;
- d) një listë të burimeve që kontribuojnë më shumë se 10 tonë metrikë merkur në vit, për të cilat AKM-ja ka informacion.

2. Format, frekuenca dhe mënyra e grumbullimit të informacionit për qëllime të përgatitjes së raportit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

VI. SANKSIONET

Mosrespektimi i parashikimeve të këtij vendimi, kur nuk përbën veprë penale përbën kundërvajtje administrative, dhe shoqërohet me ndëshkimet administrative të parashikuara në pikat 38, 39 dhe 40, të nenit 40, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

SHTOJCA I

KOMPONIMET E MERKURIT, OBJEKT I PARASHIKIMEVE TË PIKAVE 1(b) DHE 3, TË KREUT II.1, DHE PIKËS 3, TË KREUT III.1, DHE PËRZIERJET E MERKURIT OBJEKT I PARASHIKIMEVE SIPAS PIKAVE 1(b) DHE 3, TË KREUT II.1, PIKËS 1(a), TË KREUT II.2, DHE PIKËS 4, TË KREUT III.1:

1. Ndalohen të eksportohen komponimet e merkurit, si më poshtë:

- a) nga data 1 janar 2023:
 - kloruri i merkurit (I) (Hg_2Cl_2 , Nr. CAS 10112-91-1)
 - oksidi i merkurit (II) (HgO , Nr. CAS 21908-53-2)
 - xeherori i cinabarit
 - sulfuri i merkurit (HgS , Nr. CAS 1344-48-5)

b) nga data 1 janar 2025:

- sulfati i merkurit (II) (HgSO_4 , Nr. CAS 7783-35-9)
- nitrati i merkurit (II) ($\text{Hg}(\text{NO}_3)_2$, Nr. CAS 10045-94-0)

2. Përzierjet e merkurit, që ndalohen për t'u importuar dhe eksportuar, nga data 1 janar 2023, janë:

- Përzierjet e merkurit me substanca të tjera, duke përfshirë aliazhet e merkurit, me një përqendrim merkur të paktën 95% të peshës.

SHTOJCA II

PRODUKTET ME MERKUR TË SHTUAR, REFERUAR PIKËS II.3, TË KREUT II

PJESA A - PRODUKTET ME MERKUR TË SHTUAR

Produktet me merkur të shtuar	Data e ndalimit të eksportit, importit dhe prodhimit të produkteve me merkur të shtuar
1. Bateritë ose akumulatorët që përmbajnë merkur më shumë se 0.0005% të peshës.	31.12.2025
2. Çelësat dhe reletë, me përjashtim të urave matëse të saktësisë së	31.12.2025

lartë dhe humbjeve në matje, të çelësave dhe releve të frekuencave të larta dhe radio-frekuencave në instrumentet e monitorimit dhe kontrollit me një përmbajtje maksimale të merkurit prej 20 mg për urë, çelës ose rele.	
3. Llamba fluoreshente kompakte (CFL/LFL) për qëllime të përgjithshme ndriçimi: a) CFL.i \leq 30 Wat me një përmbajtje merkuri që tejkalon 2.5 mg për ndezësin e llambave; b) CFL.ni \leq 30 Wat me një përmbajtje merkuri që tejkalon 3.5 mg për ndezësin e llambave.	31.12.2023
4. Llamba fluoreshente lineare (LFLs) për qëllime të përgjithshme ndriçimi: a) fosfor tribandësh $<$ 60 Wat me përmbajtje merkuri që kalon 5 mg për llambë; b) fosfor halofosfatik \leq 40 Wat me një përmbajtje merkuri që i tejkalon 10 mg për llambë.	31.12.2023
5. Llambat me avuj merkuri në shtypje të lartë (HPMVs) për qëllime të përgjithshme ndriçimi.	31.12.2023
6. Llambat fluoreshente me katodë të ftohtë me merkur të shtuar, si më poshtë dhe llambat fluoreshente me elektrodë të jashtme (CCFL dhe EEFL) për ekranet elektronike: a) me gjatësi të shkurtër (\leq 500 mm) me përmbajtje merkuri që i tejkalon 3.5 mg për llambë; b) me gjatësi mesatare ($>$ 500 mm dhe \leq 1 500 mm) me përmbajtje merkuri që i tejkalon 5 mg për llambë; c) me gjatësi të madhe ($>$ 1 500 mm) me përmbajtje merkuri që i tejkalon 13 mg për llambë.	31.12.2023
7. Produktet kozmetike me merkur dhe komponime merkuri, me përjashtim të rasteve të veçanta për thiomers, dhe kripërat e fenilmerkurit (përfshirë boratin), në përputhje me legjislacionin për produktet kozmetike.	31.12.2025
8. Pesticidet, biocidet dhe antiseptikët topikal.	31.12.2025
Pajisjet matëse, joelektronike të mëposhtme: a) barometrat; b) higrometrat; c) manometrat; d) termometrat dhe pajisjet e tjera termometrike joelektrike; e) sfigmomanometrat f) matësit e tensionit të materialeve që përdoren me pletismografë; g) piknometrat me merkur; h) pajisjet matëse me merkur që përdoren për përcaktimin e pikës së zbutjes. Pika “h”, më sipër, nuk zbatohet për pajisjet matëse që vijnë: i. pajisjet matëse joelektronike të instaluar në aparatura të mëdha që përdoren për saktësi të lartë, për të cilat nuk ekziston alternativë e përshtatshme pa merkur; ii. pajisjet matëse më të vjetra se 50-vjeçare prej datës 3 tetor 2007; iii. pajisjet matëse që demonstrohen në shfaqet publike për qëllime kulturore dhe historike.	31.12.2025

PJESA B - PRODUKTE SHITESË TË PËRJASHTUARA NGA LISTA NË PJESËN A TË KËSAJ SHTOJCE

Çelësat dhe reletë, llambat fluoreshente me katodë të ftohtë dhe llambat fluoreshente me elektrodë të jashtme (CCFL dhe EEFL) për ekranet elektronikë dhe pajisjet matëse, kur ato

përdoren për të zëvendësuar një përbërës të një pajisjeje të madhe, me kusht që të mos ketë alternativë të mundshme pa merkur për atë përbërës, në përputhje me legjislacionin për automjetet në fund të jetës dhe kufizimet mbi përdorimin e disa substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike.

SHTOJCA III

KËRKESAT MBI MERKURIN, PËR T'U ZBATUAR NË PROCESET E PRODHIMIT, REFERUAR PIKËS 1 DHE 2, TË KREUT III.1.

PJESA I: PËRDORIMI I NDALUAR I MERKURIT OSE KOMPONIMEVE TË MERKURIT, QOFTË NË FORMË TË PASTËR APO NË PËRZIERJE, NË PROCESET E PRODHIMIT si më poshtë:

- a) nga 1 janari 2023: proceset prodhuese në të cilat mercuri ose përbërjet e merkurit përdoren si katalizator;
- b) si përjashtim nga pika "a", prodhimi i monomerit të klorurit të vinileve ndalohet që nga 1 Janari 2027;
- c) nga 1 janari 2027: proceset prodhuese në të cilat mercuri përdoret si elektrodë;
- d) si përjashtim nga pika "c", prodhimi klor-alkalin ku mercuri përdoret si një elektrodë ndalohet nga 11 dhjetori 2020;
- e) me përjashtim të pikës "c", ndalohet prodhimi i metanolatit ose etanolatit të natriumit ose të kaliumit nga 1 janari 2028;
- f) nga 1 janari 2023: prodhimi i poliuretanit, deri në masën që lejohet sipas pikës 62, të Shtojcës 1, të legjislacionit për kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm".

PJESA II: PROCESET E PRODHIMIT, QË I NËNSHTROHEN KUFIZIMEVE MBI PËRDORIMIN DHE SHKARKIMET E MERKURIT DHE KOMPONIMEVE TË MERKURIT

Prodhimi i metanolatit ose etanolatit të natriumit ose kaliumit

Prodhimi i metanolatit ose etanolatit të natriumit ose kaliumit, kryhet në përputhje me shkronjën "e", të pjesës I, të kësaj shtojce dhe, në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- a) nuk përdoret merkur i dalë nga nxjerrja parësore e mineralit të merkurit;
- b) reduktimi i shkarkimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të merkurit, komponimeve të merkurit në ajër, ujë dhe tokë me 50% për njësi prodhimi deri në vitin 2025, krahasuar me vitin 2010;
- c) mbështet kërkimin dhe zhvillimin në respekt të proceseve të prodhimit pa merkur; dhe
- d) që nga 13 Korrik 2023, kapaciteti i impianteve që përdorin merkurin dhe komponimet e merkurit për prodhimin e metanolatit ose etanolatit të natriumit ose kaliumit dhe të cilat ishin në funksionim para kësaj date, nuk do të rritet dhe nuk do të lejohen impiante të reja.

SHTOJCA IV

PËRMBAJTJA E PLANIT KOMBËTAR PËR PËRPUNIMIN DHE NXJERRJEN ARTIZANALE NË SHKALLË TË VOGËL TË ARIT, referuar pikës III.3, të Kreut III.

Plani kombëtar përfshin informacionin, si më poshtë vijon:

- a) Objektivat kombëtare dhe tragetet e reduktimit për të eliminuar përdorimin e merkurit dhe komponimeve të tij;
- b) masat për eliminimin e:
 - i. të gjithë xeherorëve të amalgamave*;
 - ii. djegien në mjedise të hapura të amalgamit ose amalgamit të përpunuar;
 - iii. djegia e amalgameve në zonat e banuara;

iv. kullimin/rrijdhjet e cianideve në sendiment, xeheror apo mbetje në të cilat është shtuar merkur, pa e larguar paraprakisht atë.

c) hapa për të lehtësuar formalizimin ose rregullimin e sektorit të minierave dhe përpunimit artizanal të arit në shkallë të vogël;

d) vlerësimet bazë të sasive të merkurit të përdorur dhe praktikave të përdorura në miniera dhe përpunimin artizanal dhe në shkallë të vogël të arit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

e) strategjitë për promovimin e reduktimit të shkarkimeve, nxjerrjen, ekspozimin ndaj merkurit në miniera dhe për përpunim artizanal dhe në shkallë të vogël të arit, duke përfshirë metodat që nuk përmbajnë merkur;

f) strategjitë për të menaxhuar tregtimin dhe parandalimin e shndërrimit të merkurit dhe përbërjeve të merkurit nga burimet e huaja dhe ato të brendshme, për përdorim në miniera dhe përpunim artizanal në shkallë të vogël të arit;

g) strategjitë për përfshirjen e aktorëve në zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të planit kombëtar;

h) strategjinë e shëndetit publik mbi ekspozimin e minatorëve artizanal dhe të vogël të arit dhe komuniteteve të tyre ndaj merkurit, duke përfshirë ndër të tjera, grumbullimin e të dhënave shëndetësore, trajnimin e personave të kujdesit shëndetësor dhe rritjen ndërgjegjësimit nëpërmjet personelit të qendrave shëndetësore;

i) strategjitë për të parandaluar ekspozimin e popullatave vulnerabël, veçanërisht fëmijët dhe femrat në periudhën e lindjes, sidomos femrat shtatzëna, ndaj merkurit të përdorur në minierat dhe përpunimin në shkallë të vogël të arit;

j) strategjitë për sigurimin e informacionit për minatorët artizanal dhe në shkallë të vogël të arit, si dhe komunitetet e prekura;

k) një plan pune për zbatimin e planit kombëtar.

SHTOJCA V RUAJTJA E PËRKOHSHME E MERKURIT METALIK

1. Ruajtja e përkohshme e merkurit metalik

Për qëllime të ruajtjes së përkohshme, për më shumë sesa 1 vit të merkurit metalik, zbatohen kushtet e mëposhtme:

a) mercuri metalik ruhet veçmas nga mbetje të tjera;

b) kontejnerët vendosen në vendruajtje të përshtatshme të mbyllura në mënyrë të tillë që të mos kenë krisje, të çara dhe të papërshtatshme nga mercuri metalik, me vëllim të përshtatshëm me sasinë e merkurit që mbajnë. Kontejnerët me merkur duhet të sigurohen në një formacion shkëmbor të pajisur me një gropë grumbullimi;

c) vendruajtja duhet të pajiset me një sistem të mbrojtjes nga zjarri;

ç) hapësira e magazinimit duhet të organizohet në një mënyrë të tillë për të garantuar se të gjithë kontejnerët administrohen lehtësisht.

2. Përbërje të merkurit

Përbërjet e merkurit, duhet të jenë në përputhje me specifikimet e mëposhtme:

a) përmbajtja e merkurit të jetë më e lartë se 99.9% e peshës;

b) pa papastërri me aftësi gërryese për karbonin ose çelikut (p.sh.: tretësirë e acidit nitrik, tretësirë e kripërave klorure).

3. Ruajtja

1. Kontejnerët e përdorur për ruajtjen e merkurit metalik duhet të jenë rezistentë ndaj ndryshkjes dhe ndaj goditjeve. Për këtë arsye duhet të shmangët saldimit. Kontejnerët duhet të përmbushin të dhënat, si vijon:

a) materiali i përbërës të jetë prej çelikut të karbonit (ASTM A36 minimum) ose çelik inoksi (AISI 304, 316L);

b) kontejnerët duhet të mbyllen hermetikisht për mos u përshkuar nga gazet dhe lëngjet;

- c) faqja e jashtme e kontejnerit duhet të jetë rezistente ndaj kushteve ku realizohet ruajtja;
- d) lloji dhe dizajni i kontejnerit duhet të kalojë me sukses testin e rënies dhe të rrjedhjes.

2. Raporti maksimal i mbushjes së kontejnerit duhet të jetë 80% i vëllimit për të siguruar një qëndrueshmëri të mjaftueshme, që as rrjedhja dhe as shtrembërimi i përhershëm i kontejnerit të mos ndodhë si rezultat i bymimit të lëngut për shkak të temperaturës së lartë.

4. Procedurat e pranimit

Lejohen për përdorim vetëm kontejnerët që shoqërohen me një certifikatë që përmbush kërkesat e përcaktuara në vijim:

- a) vetëm mercuri metalik që plotëson kriteret minimale të pranimit të përcaktuara më sipër, do të pranohet;
- b) kontejnerët duhet të inspektohet me sy para magazinimit në mënyrë që të shmanget përdorimi i kontejnerëve të dëmtuar, që rrjedhin ose përmbajnë ndryshk;
- c) kontejnerët duhet të jenë pajisur me një vulë të qëndrueshme që përmban numrin e identifikimit të kontejnerit, materialin e ndërtimit, peshën e tij bosh, referencën nga prodhuesit dhe datën e ndërtimit;
- ç) kontejnerët do të mbajnë një tabelë të përhershme ku përmendet numri i identifikimit të certifikatës.

5. Certifikata

1. Certifikata duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- a) emrin dhe adresën e prodhuesit të mbetjeve;
- b) emrin dhe adresën e përgjegjësit për mbushjen;
- c) vendin dhe datën e mbushjes;
- ç) sasinë e merkurit;
- d) pastërtinë e merkurit dhe, nëse gjykohet e nevojshme, një përshkrim të papastërtive, duke përfshirë raportin analitik;
- dh) nëse kontejnerët janë përdorur ekskluzivisht për transportimin dhe ruajtjen e merkurit;
- e) numrin e identifikimit të kontejnerit;
- ë) ndonjë koment të veçantë.

2. Certifikata lëshohet nga prodhuesi i mbetjeve ose, në mungesë të tij, nga personi përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve.

6. Kushte të posaçme për merkurin metalik

Për qëllime të ruajtjes së përkohshme për më shumë sesa 1 vit të merkurit metalik, zbatohen kushtet e mëposhtme:

Monitorimi, inspektimi dhe kërkesat emergjente

1. Në vendin e magazinimit duhet të vendoset një sistem i vazhdueshëm i monitorimit të avujve të merkurit me një ndjeshmëri prej të paktën 0,02 mg merkur/m³. Sensorët duhet të vendosen në nivelin e tokës dhe lartësinë e kokës. Kjo do të përfshijë një sistem alarmi vizual dhe akustik. Sistemi i nënshtrohet mirëmbajtjes të paktën një herë në vit.

2. Hapësira dhe kontejnerët e magazinimit duhet të inspektohen me vëmendje nga një person i autorizuar të paktën një herë në muaj. Kur zbulohen rrjedhje, subjekti menjëherë duhet të ndër marrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur çdo shkarkim të merkurit në mjedis dhe për të rivendosur sigurinë e ruajtjes së merkurit. Çdo rrjedhje konsiderohet se ka ndikim të dëmshëm mjedisor.

3. Planet e emergjencës dhe pajisjet e përshtatshme mbrojtëse për trajtimin e merkurit metalik duhet të jenë të pranishme në çdo kohë.

7. Mbajtja e të dhënave

1. Të gjitha dokumentet që përmbajnë informacionin e përmendur në pikat 4, 5 dhe 6 të këtij kreu, përfshirë certifikatën që shoqëron kontejnerin, si dhe të dhënat lidhur me shpërndarjen dhe dërgimin e merkurit metalik pas magazinimit të përkohshëm dhe destinacionit të vendtrajtimit mbahen për të paktën 3 vjet, pas përfundimit të magazinimit.

2. Mercuri metalik, përbërjet dhe përzierjet e merkurit, të depozituara në vendruajte të përcaktuara dhe kushte të veçanta, duhet të jenë të ambalazuara dhe etiketuara me simbolin e rrezikut, treguesin e rrezikut dhe të sigurisë.

3. Depozitimi dhe ruajtja e merkurit metalik, përbërjeve dhe përzierjeve të merkurit, si substanca të kategorizuara me rrezik për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin i nënshtrohet procedurës së lejes dhe regjistrimit, kontrollit dhe marrjes së masave mbrojtëse për ruajtjen e mjediseve të ruajtjes në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.